



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/22

Datë: 03.04.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 3 prill 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja-Ministry of Environment and Spatial
Planning

KONCEPT DOKUMENT PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA

Hyrje

Gjatë zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Nr. 03/L-160 janë vërejt mangësi në këtë ligji. Në këtë ligj nuk përfshihen të gjitha obligimet që dalin nga legjislacioni i BE, për çështjet e mbrojtjes së ajrit, ndryshimet klimatike dhe për mbrojtjen e shtresës së ozonit. Për të kompletuar ligjin në fjalë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), propozon ndryshimin dhe plotësimin e këtij Ligji.

Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, është planifikuar me Planin e Punës të MMPH. (Objektivi 5 Kompletimi i infrastrukturës ligjore, pika 5.3: Hartimi i koncept dokumentit për nevojat e ndryshim plotësimit të Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga ndotja)- Programin legjislativ për vitin 2014 dhe PVMSA (Veprimi 3, indikator 3.),

Dokumenti i cili autorizon MMPH, për rregullimin e çështjes së mbrojtjes së ajrit nga ndotja, është Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Neni 15 (Mbrojtja e përbërësve të mjedisit) - Mbrojtja dhe ruajtja e përbërësve të mjedisit: tokës, ujit, ajrit, pyjeve dhe llojlojshmërisë biologjike dhe peizazhore, bëhet veç e veç dhe të lidhura ngushtë mes veti në ndërveprimin dhe integritetin e tyre, ndërsa rregullohen me ligje të veçanta.

Koncept dokumenti për ndryshimi dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, përmban opsionet për zgjidhjen e problemeve për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, duke përfshirë ndikimet në mjedis, shëndet të njeriut, në pronën dhe ndikimi ekonomik dhe social.

Gjatë procesit të përgatitjes së këtij dokumenti janë konsultuar institucionet relevante dhe janë marrë parasysh propozimet e tyre të arsyeshme.

KAPITULLI 2

Përshkrimi dhe definimi i çështjes/ problemit kryesor

1. Ligji ekzistues për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, nuk është në përputhshmëri të plotë me Direktivat dhe Rregulloret e Bashkësisë Evropiane, në lidhje me mbrojtjen e ajrit, shtresës së ozonit dhe ndryshimeve klimatike. Kjo ka ndikuar që këto çështje të mbesin të pa trajtuara.

Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja nr. 03/L-160, do të i përfshijë të gjitha çështjet e pa përfshira, në ligjin ekzistues (të gjitha obligimet që dalin nga Direktivat e BE-së për ajër, ndryshimet klimatike dhe për mbrojtjen e shtresës së ozonit) dhe me këtë rast do të harmonizohet me *acquis communautaire*.

Ligji ekzistues nuk përfshinë të gjitha obligimet që dalin nga Direktivat dhe Rregulloret e BE, ato janë:

1. Direktiva 2008/50/EC për cilësinë e ajrit mjedisor
2. Direktiva 2004/70/EC për arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajrin mjedisor.
3. Direktiva 2001/81/EC për kufijtë kombëtarë të emisioneve për disa ndotës atmosferik
4. Direktiva 2003/87/EC - krijimit të një skeme për tregtimin e kuotave të emisioneve të gazrave serë brenda komunitetit me të cilën amandamentohet direktiva 96/61/EC
5. Direktiva 2004/101/EC me të cilën amandamentohet Direktiva 2003/87/EC - krijimit të një skeme për tregimin e kuotave të emisioneve të gazrave serë brenda komunitetit lidhur me mekanizmat e Kyoto Protokollit.
6. Direktiva 2008/101/EC me të cilën amandamentohet Direktiva 2003/87/EC - krijimit të një skeme për tregimin e kuotave të emisioneve të gazrave serë brenda komunitetit.
7. Direktiva 2009/29/EC me të cilën amandamentohet Direktiva 2003/87/EC për të përmirësuar dhe zgjeruar sistemin e tregimit të emisioneve brenda komunitetit.
8. Direktiva 2009/30/EC me të cilën amandamentohet Direktiva 98/70/EC e në lidhje me specifikimet e benzinës dhe naftës si dhe naftës së gazit si dhe prezantimin e një mekanizmi për monitorimin dhe redukimin e emisioneve të gazrave serë si dhe amandamenti i Direktivës 199/32/EC për specifikimin e karburantit të përdorur nga anijet për lundim të brendshëm si dhe shfuqizimin e Direktivës 93/12/EEC
9. Vendimi 406/2009/EC për përpjekjet e Shteteve Anëtare të zvogëlojnë emisionet e gazrave serë që ti plotësojnë obligimet e Komunitetit për zvogëlimin e gazrave serë deri më 2020.
10. Vendimi i Komisionit 2011/278/BE për përcaktimin e rregullave kalimtare në nivel të Bashkësisë për shpërndarjen pa pagesë të kuotave të njëjësive të emisioneve në përputhje me nenin 10, të Direktivës 2003/87/BE.
11. Rregulloren (BE) Nr. 1005/2009 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për materiet të cilat e dëmtojnë shtresën e ozonit
12. Rregulloren (BE) Nr. 842/2006 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për gazrat serë të fluoruara të caktuara
13. Vendimi i Këshillit Nr. 97/101/BE me të cilën vendoset shkëmbimi reciprok i informatave dhe shënimeve të marra nga rrjetet dhe stacionet e veçanta të cilat masin papastërtinë e ajrit mes shteteve anëtare
14. Vendimi i Këshillit Nr. 2001/752/BE me të cilën ndërrohen shtojcat e Vendimit të Këshillit 97/101/BE
15. Vendimi i Komisionit Nr. 2004/224/BE me të cilën përcaktohet mënyra e dhënies së informatave për planet ose programet të cilat kërkohen sipas Direktivës 96/62/BE për vlerat kufitare për materiet e veçanta ndotëse në ajrin mjedisor
16. Vendimi i Këshillit Nr. 2004/461/BE me të cilën përcaktohet pyetëtori për paraqitjen e raportit vjetor për cilësinë e ajrit sipas Direktivës së Këshillit

- 96/62/BE dhe 1999/30/BE si dhe sipas Direktivave 2000/69/BE dhe 2002/3/BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian (ka zëvendësuar Vendimin 2001/839/BE)
17. Vendimi Nr. 280/2004/BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për mekanizmin e përcjelljes së gazrave serë në Bashkësi dhe për zbatimin e Protokollit të Kyotos
 18. Rregullores të Komisionit (BE) Nr. 1031/2010 për ndarjen, udhëheqjen dhe aspektet tjera të ndarjes së kuotave të emisioneve të gazrave serë sipas Direktivës 2003/87/BE të Parlamentit dhe Këshillit Evropian për vendosjen e sistemit të tregëtimit me kuota të emisioneve të gazrave serë brenda Bashkësisë
 19. Vendimi i Komisionit Nr. 2007/589/BE me të cilën merren vendimet për përcjelljen dhe raportimin e emisioneve të gazrave serë sipas Direktivës 2003/87/BE, e cila është ndryshuar dhe plotësuar me Vendim të Komisionit 2011/540/BE
 20. Direktiva 2010/75/EU e Parlamentit dhe Këshillit Evropian për emisionet nga industria

2. Ndotja e ajrit dhe ndikimet e saj

Ndotja e ajrit atmosferik është treguar se ka efekte negative në shëndetin e njeriut, ekosistemet dhe strukturat tjera. Disa ndotës, prezent në sasi të vogla në ajër, mund të mos kenë një ndikim, mirëpo ata mund të mblidhen në një rajon në atë masë që mund të shkaktojnë efekte në shëndet dhe mjedis. Këto quhen përgjithësisht ndotës rajonal të ajrit, ku si shqetësim më i madh janë; bashkëdyzimet organike të avullueshme (VOCs/KOA) (p.sh. benzina ose tymi tretës dhe një sasi e madhe e karbonit dhe gazet tjera, kryesisht me një erë të dallueshme); oksidet e azotit (shpesh referohet si NO_x); pluhur- grimca (pluhur veçanërisht grimca shumë të vogla të cilat i thithim); monoksidi i karbonit (CO - kryesisht nga automjeteve motorike) dhe bashkëdyzimet e sulfurit, në përgjithësi. Disa ndotës mund të kenë ndikime globale- për shembull, dëmtimi i shtresës së ozonit dhe rritja e efektit të gazeve serrë.

Edhe pse ndotja e ajrit tradicionalisht i ngarkohet aktiviteteve njerëzore, ajo gjithashtu mund të lind nga natyra, burimet e tilla si stuhitë dhe aktivitetet biologjike. Është gjithashtu interesante të përmendet se ndotja mund të shkaktohet edhe brenda objekteve dhe në shtëpi, nga tymi i cigareve, pluhuri, ngrohja dhe gatimi, të cilët shpesh mund të jenë në përqendrim më të larta se sa që është jashtë.

Ndikimi në mjedis- Është e njohur se ndotja e ajrit mund të ketë një ndikim negativ në mjedis, shëndet dhe komoditet. Mirëpo është e vështirë të përcaktohet niveli i efekteve.

Me shumë studime dhe analiza të bëra, është vendosur lidhja në mes ndotjes së ajrit dhe dëmit në ekosistem, veçanërisht nga ndotja e shkaktuar nga transporti në distancat e mëdha "ndotja ndërkontinentale". Ku si pasojë e kësaj kemi acidifikimin, eutrofikimin dhe epizodat e ozonit troposferik.

Acidifikimi i referohet depozitimit të ndotësve acidik (kryesisht SO₂, NO_x dhe amoniumi -NH₃), që ndikon në vegjetacion, ujë dhe tokë.

Eutrofikimi i referohet problemit të depozitimit të tepërt të prodhimeve ushqimore (nga aktivitetet njerëzore) në ekosistem, veçanërisht nga bashkëdyzimet e azotit.

Vlerësimi i ndikimit të ndotjes së ajrit në ekosistemet është studiuar pak, por ndikimet pritet të përfshijë:

- * Dëmtimin dhe zhdukjen e llojeve të ndjeshme;
- * Humbjen e shumëllojshmërisë biologjike;
- * Kontributin e ngarkesave të tepërta, në ujëra;
- * Humbjen e ekosistemeve specifike.

Ndikimi në shëndet- Efektet e ndotjes në shëndet të njeriut janë një shqetësim i veçantë. Këto shpesh shkaktojnë efekte të konsiderueshme dhe qojnë deri në debate të mëdha publike.

Efektet nga ndotja ndryshojnë në varësi të ndotësit dhe përfshinë:

- * Sëmundjet akute respiratore;
- * Keqësimin e gjendjes së të sëmurëve nga zemra, organeve respiratore dhe astma ose problemeve të tjera të frymëmarrjes;
- * Kacerët, shkaktuar direkt nga ndotësit;
- * Ndikimet në sy ose iritim të hundës, stresin ose humbjen e mirëqenies së përgjithshme

Derisa në shumicën e rasteve, efekte janë të vogla, në disa raste ndikimi mund të jetë i madh dhe në raste ekstreme, kërcënues për jetën.

Dëmtimi i pronës-Shqetësim për shumë shoqëri është ndikimi i shirave acidike të cilat ndikojnë në dëmtimin e pronës, veçanërisht monumenteve kulturore dhe historike por edhe të dëmtimit të pronave private që përfshinë; Dëme në strukturat e ndërtimit po edhe depozitimi i blazës dhe grimcave në ndërtesat, që kërkon pastrim dhe mirëmbajtje shtesë.

Ndikimi i ndotjes së ajrit në ekonomi- mund të jetë ndjerë në shumë zona dhe është shpesh një rezultat i ndikimeve të listuara në titujt e më sipërm. Disa nga efektet që mund të identifikohen përfshijnë:

- * Zvogëlimin e vlerave të pronës;
- * Pengesë për zhvillimin e industrive të reja apo vendbanimeve të reja;
- * Humbje e potencialit të turizmit, etj.

3. Aktualisht, kontribuuesit më të mëdhenj të ndotjes së ajrit në Kosovë janë, burimet e palëvizshme dhe ato të lëvizshme: objektet për prodhimin e energjisë, objektet industriale (metalurgjia, mihjet, fabrika e çimentos, etj), sektori i transportit, aktivitetet

bujqësore dhe lokacionet ku hedhen mbeturinat.¹

Niveli i ndotjes së ajrit në Kosovë, është bazuar në të dhënat e mbledhura për emisionet nga burimet e veçanta.² Për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme gjerë më tani nuk janë të evidentuara të gjitha të dhënat e emisioneve. Megjithatë është pranuar, se këto burime në mënyrë të konsiderueshme kontribuojnë në ngritjen e nivelit të ndotjes.

Duke marrë parasysh të gjitha burimet e ndotjes së ajrit, konsiderohet se e gjithë popullata është e prekur nga kjo ndotje. Në përmasa më të mëdha konsiderohet se janë të prekura vendet ku zhvillohen veprimtaritë industriale ndërsa vendet tjera janë më pak të prekura.

Gjendja aktuale dhe politikat

1. Në Kosovë, cilësia e ajrit është e dëmtuar në zonat e zhvilluara urbane, posaçërisht në zonat industriale. Ndikimi më i madh në mjedis shkaktohet nga termocentralet e KEK-ut (TCA dhe TCB), nga industritë (metalurgjia, mihjet, fabrika e çimentos, etj.) aktivitetet bujqësore dhe lokacionet ku hedhen mbeturinat dhe nga burimet tjera të vogla. Ndotje shkaktohet po ashtu edhe nga objektet individuale për ngrohje. Mitrovica me pasojat nga mbeturinat industriale, të mbetura nga kompleksi i Trepçës, numërohet po ashtu ndër burimet e mëdha të ndotjes.

Burimet e emetimeve në ajër, vijnë nga të gjitha kategoritë kryesore industriale dhe tregtare, aktivitetet tjera, mjeteve motorike dhe gjithashtu burimet nga emetimet e vegjetacionit biogjenik.

Në Kosovë, cilësia e ajrit është i dëmtuar në zonat e zhvilluara urbane veçanërisht në zonat industriale. Rajoni i Prishtinës psh. është zonë me ndotje më të lartë të ajrit e cila shkaktohet nga termocentralet e KEK-ut (TCA dhe TCB), industrive tjera më të vogla, transporti, ngrohja, nga objektet individuale për ngrohje e tj.

Në të shumtën e rasteve ndotja paraqitet në formë të emisioneve të dyoksidit të sulfurit (SO₂), oksideve të azoti (NO_x), ozonit (O₃), plumbit (Pb), dyoksidit të karbonit (CO₂), pluhurit, tymit, grimcave PM₁₀, PM_{2.5}, bashkëdyzimet organike të avullueshme (KOA/VOCs) dhe dioksinat.

Vlerësimi i përafërt i cilësisë së ajrit në Kosovë, është bazuar në një sërë të dhënash në dispozicion,³ duke marrë si pikë krahasimi standardet e BE-së, mbi cilësinë e ajrit, të Direktivës 2008/50/EC.

¹ Strategjia për Cilësinë e Ajrit, 2013- 2022

² Strategjia për Cilësinë e Ajrit, 2013- 2022

³ Strategjia për Cilësinë e Ajrit, 2013- 2022

Burimet e ndotjes së ajrit në Republikën e Kosovës, janë të bazuara në të dhënat e mbledhura për emisionet. Për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme, nuk janë përfshirë të gjitha të dhënat e emisioneve. Megjithatë është pranuar, se këto burime në mënyrë të konsiderueshme kontribuojnë në ngritjen e nivelit të ndotjes.

Analiza e këtyre të dhënave tregon mospërputhshmëri me standardet e përcaktuara të BE-së, që na shtyn në ndërmarrjen e veprimeve për kontrollimin dhe monitorimin e emisioneve nga ndotësit.

2. Me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja dhe akteve nënligjore të dala nga ky ligj, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është përgjegjëse për menaxhimin e cilësisë së ajrit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Organet e veçanta të MMPH, kryejnë detyrat e veçanta, të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja dhe në aktet tjera ligjore.

Dispozitat e përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, paraqesin obligim për të gjitha komunitetet dhe ato janë përgjegjëse për të realizuar veprimet, për arritjen e objektivave për cilësinë e ajrit.

3. Sistemi aktual institucional, është zhvilluar nga fundi i vitit 2002. Në parim, përbëhet nga një sistem menaxhimi institucional, i shpërndarë.

Institucionet për menaxhim të mjedisit ndjekin legjislacionin në fuqi, të R. së Kosovës dhe standardet e BE.

Sistemi për administrimin e mjedisit/ cilësisë së ajrit, përfshinë:

- Kuvendin e Republikës së Kosovës – organi më i lartë legjislativ;
- Qeverinë e Republikës së Kosovës
- Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Ministria) – organi i lartë ekzekutiv mbi territorin e Kosovës që krijon dhe zbaton politikën kombëtare mjedisore dhe koordinimin me shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare mjedisore;
- Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit (DMM) - zhvillon politikat mjedisore dhe legjislacionin përkatës, gjithashtu edhe instrumentet për zbatimin e këtyre politikave dhe legjislacionit, në përgjithësi.
- Komuna- organ ekzekutiv mbi territorin e komunës, përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit dhe planeve komunale mjedisore.

4. Edhe pse Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja dhe Strategjia për Mjedisin e Kosovës dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm (2005-2015) janë duke u zbatuar dhe janë realizuar disa projekte mjedisore në sektorin e energjetikës (vendosja e elektrofiltarve në njësitë e termocentralit A), industrisë dhe minierave (rehabilitimi i 2 deponive industriale, në minierën e Artanës dhe minierën e Stantërgut) , cilësia e ajrit në zonat urbane dhe ato industriale vazhdon të mbetet, ende një problem, siq është trafiku,

infrastruktura rrugore, elektrofiltrat e termocentralit B, rehabilitimi i deponive tjera të Trepçës etj., (të gjitha janë të përshkruara në Strategjia për Cilësinë e Ajrit, 2013- 2022).

5. Një përparim është shënuar me miratimin e Strategjisë për Cilësinë e Ajrit (2013-2022) dhe ngritjen e kapaciteteve njerëzore,(trajnimet e zyrtarëve) në nivelin qendror dhe lokal. Megjithatë, mangësitë janë ende evidente në nivelin e zbatimit të legjislacionit (mos zbatimi i obligimeve që dalin nga legjislacioni për ajër, nga ana e ndotësve).

Ligjet dhe Aktet nënligjore

1. Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr. 03/L-025, obligon MMPH për nxjerrjen e Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, sipas Nenit 15 (Mbrojtja e përbërësve të mjedisit) i Mbrojtja dhe ruajtja e përbërësve të mjedisit: tokës, ujit, ajrit, pyjeve dhe llojlojshmërisë biologjike dhe peizazhore, bëhet veç e veç dhe të lidhura ngushtë mes veti në ndërveprimin dhe integritetin e tyre, ndërsa rregullohen me ligje të veçanta.

2. Aktet nënligjore që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, janë:

- a. U. A. Nr. 06/2007 për Rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes
- b. U. A. Nr .04/2009 për Kontrollin emisioneve të bashkëdyzimeve organike të avullueshme gjatë deponimit zbrazjes, mbushjes dhe transportimit të karburanteve
- c. U. A. Nr. 15/2010 për Kriteret për përcaktimin e pikave monitoruese, numrin dhe shpeshtësinë e matjeve, klasifikimin e ndotësve të cilët monitorohen, metodologjinë e punës, formën dhe kohën e raportimit të dhënave
- d. U. A.Nr .02/2011 për Normat e cilësisë së ajrit
- e. U.A. Nr. 03/2011 për Normat e cilësisë së ajrit nga burimet e lëvizshme
- f. U.A. (QRK) Nr. 16/2013 për Substancat që dëmtojnë shtresën e ozonit dhe gazrat serë të fluoruara
- g. U.A. (QRK) Nr.19/2013 për Qasje në informata për shpenzimin ekonomik të karburanteve dhe emisionin CO₂ të automjeteve të reja personale
- h. U.A. (QRK) Nr.20/2013 për Zbatimin e mekanizmave fleksibil për zhvillim të pastër
- i. U.A. (QRK) Nr.21/2013 për Arsenin, kadmiumin, merkurin, nikelin dhe hidrokarburet aromatike policiklike në ajër

Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Nr. 03/L-214

Ligji për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, Nr. 03/L-043, etj.

Gjatë zbatimit të ligjeve të lartpërmendura nuk është vërejtur ndonjë konflikt mes këtyre ligjeve dhe Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, përkundrazi ato e mbështesin njëri tjetrin, në favor të zbatimit të masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes, duke u nisur prej planifikimit të një veprimtarie, fillimin e punës dhe gjatë zhvillimit të

asaj veprimtarive.

Programi aktual

1. Strategjia për Cilësinë e Ajrit (2013- 2022) përbën kornizën themelore për zvogëlimin dhe parandalimin e ndotjes së ajrit, në bazë të së cilës, do të përgatitet Plani i Veprimit për Cilësinë e Ajrit, me të cilin, përmes politikave të përcaktuara, do të realizohen hapat e mëtejshëm, në harmonizimin e legjislacionit me dispozitat e BE-së, zbatimin e legjislacionit dhe standardeve, në koordinim me strategjitë dhe planet tjera të veprimit.
2. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, si organ i Qeverisë së Republikës së Kosovës është përgjegjëse për hartimin e Strategjisë për Cilësinë e Ajrit, duke u siguruar se të gjitha organet tjera dhe komuniteti i gjerë, janë të vetëdijshëm për rëndësinë e kontributit të tyre për arritjen e një cilësie të mirë, të ajrit.
3. Meqenëse kontribuesit kryesorë të ndotjes së ajrit janë sektorët e ndryshëm, të cilët monitorohen nga ministritë dhe komunat, kjo strategji adreson në mënyrë specifike masat e nevojshme të cilat do të zbatohen nga këto autoritete.

Shpenzimet aktuale

Tabela 1. përmban koston vjetore të shërbimeve, për zbatimin e ligjit

<i>Kategoritë e shpenzimeve</i>	<i>Shpenzimet faktike në vitin paraprak</i>	<i>Buxheti këtë vit</i>	<i>KASH për vitin e ardhshëm</i>
<i>Buxheti i Ministrisë:(shëno secilin lloj të shpenzimit) total buxheti i Ministrisë duke përfshi kapitale dhe mallra e shërbime paga mëditje dhe shpronësimet</i>	44,236,781.69	44,870,026	46,000,000.00
<i>Buxhetet tjera: (shëno secilin lloj të shpenzimit) Financimet nga huamarrjet, mallra dhe shërbime dhe kapitale</i>	1,250,687.87	2,915,000	
<i>Financimi nga donatorët, nga linja mallra shërbime dhe paga mëditje si dhe investime kapitale</i>	592,024.22	780,108.58	
<i>Shpenzimet e drejtpërdrejta nga Ministria e Financave</i>	0	0	

Vlerësimi plotësues i politikës aktuale

Bazuar në faktin që Kosova synon në një zhvillim më të lartë ekonomik kjo mund të rrezikon cilësinë e ajrit edhe më tepër.

Sfidë kryesore për zvogëlimin e shkarkimeve të emisioneve në ajër janë kufizimet financiare të kompanive publike dhe ato private, për të investuar në teknologjitë e tyre, për zvogëlim të emisioneve.

Përvojat në shtetet tjera

Shtetet e rajonit kanë kaluar nëpër fazat e tranzicionit ashtu si që po kalon edhe Kosova. Kështu që përvojat në këto shtete, si në zhvillimin e legjislacionit, po ashtu edhe në zbatimin e tij, nuk dallojnë shumë nga Kosova.

KAPITULLI 3

Synimet dhe Objektivat

Strategjia për cilësinë e ajrit cakton objektivat për cilësinë e ajrit dhe politikat alternative për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së ajrit, prej sot e më tutje. Gjithsesi si përfitim direkt për shëndetin e popullatës. Këto alternativa janë menduar për të siguruar përfitime të rëndësishme për cilësinë e jetës dhe ndihmesë në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Synimet

- Përcaktimi dhe vendosja e objektivave për cilësinë e ajrit mjedisor, për të synuara shmangien, parandalimin dhe uljen e pasojave të dëmshme për shëndetin e njeriut dhe mjedisin në tërësi.
- Vlerësimin e cilësisë së ajrit mbi bazën e metodave dhe kritereve të përcaktuara.
- Marrja e informatave të mjaftueshme për cilësinë e ajrit në mënyrë që të luftohet ndotja e ajrit, përmirësimi i të cilit do të rezultojë nga masat kombëtare dhe të komunitetit.
- Ruajtja e cilësisë së ajrit, kur është në nivelin e kërkuar dhe për ta përmirësuar atë në rast, kur tejkalohen vlerat e lejuara.
- Për të siguruar disponueshmërinë e këtyre informatave për publikun.
- Harmonizimi i ligjit aktual me Direktivat dhe Rregulloret e lartpërmendura të Parlamentit dhe Këshillit Evropian si dhe mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut.

Objektivat

- Transpozimi i direktivave të BE, në legjislacionin e Kosovës dhe zbatimi i tij
- Sigurimi i kornizës për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, në bashkëpunim me të gjithë komunitetet
- Promovimi i rëndësisë së cilësisë së ajrit si përcaktues i shëndetit dhe mirëqenies së popullatës

Me arritjen e qëllimeve dhe objektivave të do të sigurohet:

- Mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit të popullatës
- Demonstrimi i angazhimit të Qeverisë, industrive dhe individëve në mbrojtjen e cilësisë së ajrit
- Sigurimi i kornizës strategjike, për ndërmarrjen e iniciativave për një ajër të pastër, në të ardhmen, në bashkëpunim me partnerët lokal dhe ndërkombëtar, institucionet shkencor dhe shoqërisë civile
- Përpjekja e vazhdueshme për përmirësimin e cilësisë së ajrit, duke i marrë parasysh performancën ekonomike dhe efqiencën
- Identifikimi i zonave dhe çështjeve me fokus special
- Nxitja për efqiencën e energjisë përmes kujdesit gjatë dizajnit, shfrytëzimit dhe ri shfrytëzimit të materialeve.

Hartimi i Ligjit me propozimet për zbatim më të lehtë të tij, rezulton në plotësimin e prioritetit të Qeverisë për sundimin e Ligjit

KAPITULLI 4

Opsionet

Strategji për Cilësinë e Ajrit cakton objektivat për cilësinë e ajrit dhe politikat alternative për përmirësimin e mëtejme të cilësisë së ajrit, prej sot e më tutje. Gjithsesi si përfitim direkt për shëndetin e popullatës dhe mjedisin.

Për të siguruar përfitime të rëndësishme për cilësinë e jetës dhe ndihmesë në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, janë analizuar këto opsione;

- Opsioni i parë- Mos ndryshimi i Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja
- Opsioni i dytë- Plotësimi i pjesshëm
- Opsioni i tretë- Ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja

Përfitimet

Opsioni i parë:

Me mos ndryshimin e Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, nuk do të mund të përfshihen të gjitha obligimet që dalin nga legjislacioni i BE, për çështjet e mbrojtjes së ajrit, ndryshimet klimatike dhe për mbrojtjen e shtresës së ozonit. Supozohet se ky opsion do të rezultojë në përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ndikimit në mjedis, por në nivel shumë më të ulët, se sa opsioni i tretë.

Opsioni i dytë:

Ndryshimi i pjesshëm (mospërfshirja e të gjitha fushave të lartë përmendura) i Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja- Plotësimi i pjesshëm i Ligjit në fjalë, kërkon konsultime dhe mbështetje të vazhdueshme të institucioneve në nivel qendror dhe lokal dhe të Komisionit Evropian. Supozohet se ky opsion do të rezultojë në përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe ndikimit në mjedis, por në nivel më të ulët, se sa opsioni i tretë.

Opsioni i Tretë:

Republika e Kosovës është duke u angazhuar fuqimisht në arritjen e kushteve për procesin e negociatave për pranimin dhe anëtarësimin e plotë në BE, ku si sfidë e veçantë është harmonizimi me *aquis communautaire* dhe zbatimi i tij, për fushën e mbrojtjes së ajrit. Kjo kërkon ndryshime sistematike institucionale, organizative dhe investime në teknikat më të mira në dispozicion, në mënyrë që të përmbushen objektivat e vendosura në lidhje me zvogëlimin dhe parandalimin e efekteve të dëmshme në shëndet dhe të gjithë komponentët e mjedisit.

Për të i përmbushur këto objektiva në fushën e mbrojtjes së ajrit nga ndotja duhet të përfshihen edhe;

- Fushëveprimi, me të cilin përcaktohen fushat që do të shtjellohen në këtë ligj
- Masat për mbrojtjen e ajrit
- Autoritetet përgjegjëse
- Plotësimi me disa definicione; arseni, kadmiumi, plumbi, benzopireni; synimet e zvogëlimit të ekspozimit në nivel kombëtar; burimet difuzive; pragut i ulët i vlerësimit; synimi afatgjatë; oksidet e karbonit; e dhëna për emisionet; vlerësimi i pragut të lartë; vendi i sfondit urban; kufiri i tolerancës; shpeshësia e matjeve/mostrimit; matjet indikative; kontrolli i cilësisë; metodat e matjeve; matja; rrjeti; vlerësimi; ajri i ndotur; ndotja nga burimet e natyrës; ndotësi; planet për cilësinë e ajrit; e dhëna për cilësinë e ajrit; treguesi i cilësisë së ajrit; hidrokarburet policiklike aromatike; treguesi indirekt i cilësisë së ajrit;
- Planet dhe programet;

- Përcjellja dhe vlerësimi i cilësisë së ajrit
- Zonimi/ aglomerimi
- Monitorimi i cilësisë së ajrit
- Masat për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotësve të ajrit
- Ndotja nga burimet natyrore
- Ndotja ndërkuftare
- Matjet
- Licencimi,

të cilat nuk janë të përfshira në Ligjin ekzistues për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja. Përfshirja e këtyre çështjeve do të ndikoi në ndryshimin e Ligjit ekzistues mbi 40%. Me këtë rast (sipas rregullave) si obligim del hartimi i një ligji të ri për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja.

Miratimi i këtij ligji, nxjerrja e Udhëzimeve Administrative që dalin nga ai dhe zbatimi i tyre do të përmirësoi cilësinë e ajrit, si dhe;

- kategorizon dhe definon burimet e ndotjes, si; burimet e palëvizshme të ndotjes; burimet e lëvizshme të ndotjes dhe ato difuzive.
- vendos indikatorët (treguesit bazë- dioksidi i sulfurit; monoksidi i karbonit dhe dioksidit të karbonit; ozoni tokësor; prekursorët e ozonit; metalet e rënda (plumbi, mercuri, arseni, kadmiumi, nikeli dhe bashkë dyzimet e tyre); hidrokarburet (benzeni); benzopireni dhe hidrokarburet tjera policiklike aromatike; oksidet e azotit; halogjenet; grimcat fluturose (PM10, PM 2.5, PM1) dhe obligimet themelore për mbrojtjen e ajrit respektivisht përdorimin e teknologjive për zvogëlimin e emisioneve deri në nivelin e lejuar të emisioneve (për burimet e palëvizshme të ndotjes), trafiku (përcaktimi i masave për lirim të emisioneve nga automjetet dhe përmirësimin e infrastrukturës së rrugëve.
- rekomandon miratimin e vlerave kufitare të emisioneve (VKE) dhe normat e cilësisë së ajrit, konform standardeve të BE-së dhe OBSH, të cilat rregullohen me U.A të veçanta.
- si pjesë e programit të përgjithshëm për mbrojtjen e mjedisit, ligji në fjalë, inicion përgatitjen e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit,
- obligon komunat për hartimin e programeve lokale për mbrojtjen e ajrit në kuadër të Planeve të tyre Zhvillimore Komunale

KAPITULLI 5

Përmbledhja e opsioneve

<i>Përmbledhja e opsioneve</i>			
<i>Karakteristikat</i>	<i>Opsioni 1</i>	<i>Opsioni 2</i>	<i>Opsioni 3</i>

<i>kryesore</i>	<i>Status-quo</i>	<i>plotësim ndryshimi i kornizës aktuale</i>	<i>Hartimi i Ligjit të ri</i>
<i>Karakteristikat kryesore të opsionit</i>	Ruajtja e gjendjes ekzistuese që nënkupton mos ndryshimin e gjendjes aktuale në aspektin e mbrojtjes së ajrit nga ndotja.	Plotësimi i pjesshëm i legjislacionit	Plotësimin dhe ndryshimi i Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja në përputhshmëri me Direktivat dhe Rregulloret e lartcekura të Komisionit dhe Këshillit Evropian.
<i>Segmenti i popullsisë /sektori/rajoni i shënjestruar</i>	Përfshihen të gjitha komunitetet	Përfshihen të gjitha komunitetet	Përfshihen të gjitha komunitetet
<i>Karakteristikat e zbatimit - kush është përgjegjës - një resor i Qeverisë (cili), sektori privat, qytetarët</i>	MMPH Institucionet relevante si Ministrinë: përgjegjëse për mjedis, energji, miniera, industri, shëndetësi, komunikacion, komunat , , sektori privat (veprimtaritë e ndryshme që emitojnë gazra dhe qytetarët	MMPH Institucionet relevante të niveli qendror dhe lokal, sektori privat dhe qytetarët	MMPH Institucionet relevante të niveli qendror dhe lokal, sektori privat dhe qytetarët
<i>Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit</i>	MMPH	MMPH	MMPH
<i>Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet</i>	Baza e Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga ndotja është Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Nr. 03/L-025.	Plotësim ndryshimi i Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja	Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja
<i>Stimulimet ose mos- stimulimet ekonomike -</i>	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka

<i>subvencionet ose taksat</i>			
<i>Fushatat e edukimit dhe komunikimit</i>	Takime me palë të interesit për ndryshim dhe plotësim më të shpejtë të këtij ligji.	Parashihet fushatë promovuese	Parashihet fushatë promovuese
<i>Udhëzimet</i>	Në harmoni me legjislacionin e BE	Në harmoni me legjislacionin e BE	Në harmoni me legjislacionin e BE
<i>Afatet kohore - kur hyn në fuqi opsioni</i>	Është në fuqi	Deri në fund të viti 2014	Deri në fund të viti 2015

KAPITULLI 6

Analiza e opsioneve

Ky veprim legjislativ do të ishte në vijë të plotë me përkushtimin e Qeverisë për vendosjen e ligjshmërisë dhe rregullave për mbrojtjen e ajrit, që do të ishte në pajtim me legjislacionin e BE-së dhe vendeve të rajonit.

Me ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji do të ndikohet në zvogëlimin e ndotjes së ajrit që ndikon në parandalimin dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit, që do të reflektohet në mirëqenien e popullatës, respektivisht parandalimin e sëmundjeve që mund të shkaktohen nga ndotja e ajrit dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore të tyre, mbrojtjen e biodiversitetit, cilësisë së ujërave etj., veçanërisht në zonat urbane ku kemi një trafik shumë të dendur, në zonat industriale, me theks të veçantë zona e regjionit të Prishtinës ku janë termocentralet.

Përfitimet e aktiviteteve për sigurimin e cilësisë së mirë të ajrit

Me ndryshimin dhe plotësimin e këtij Ligji krijohen mekanizma dhe instrumente që do të lehtësojnë zbatimin e tij dhe të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit në Republikën e Kosovës, edhe atë me..

Menaxhimi i cilësisë së ajrit: përfshinë mbledhjen dhe analizën e informatave dhe monitorimin e të dhënave, për të kryer procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të cilësisë së ajrit. Ministria është organ përgjegjës për hartimin e këtij ligji duke u siguruar se të gjitha organet tjera, agjencioni dhe komuniteti i gjerë janë të vetëdijshëm për rëndësinë e kontributit të tyre për arritjen e një cilësie të mirë të ajrit.

Kontrolli i ndotjes: aktivisht kontribuon në zvogëlimin e ndotjes nga burimet vendore dhe komerciale, përmes kombinimit të zbatimit të legjislacionit, edukimit dhe përforcimit teknik.

Kontrolli i emisioneve nga burimet stacionare dhe mobile: Ministria me strukturat e veta ka për detyrë zbatimin e legjislacionit, të kryej matjet e cilësisë së ajrit dhe kontrollin e emisioneve nga burimet stacionare.

Planifikimi i politikave dhe zhvillimi i kontrollit: kontribuon në mënyrë të dukshme në përmirësimin e cilësisë së ajrit në nivelin strategjik dhe operacional, përmes integritit të udhëzimeve (udhëzuesve) për planifikim të politikave në nivel qendror dhe nivel lokal.

Kushtet e planifikimit dhe marrëveshjet, luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së ajrit, p.sh. përmes sigurimit të masave të ndërmarra nga operatorët dhe arritjes së ndryshimeve në mënyrën e organizimit të transportit.

Efiqenca e energjisë: përmirësimi i pajisjeve vendore, bizneseve dhe objekteve të administratës kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Zbatimi i këtyre veprimeve do të ndihmoi në:

- Zvogëlimin e emisioneve nga transporti me përcaktimin e standardeve për karburant më të pastër dhe opsione tjera për efiqencë të energjisë.
- Promovimi aktiv për harxhimin e energjisë në mënyrë sa më racionale në amvisëri.
- Sigurimin e bashkëveprimit të të gjitha komuniteteve për të kuptuar rëndësinë dhe kontributin dhe inkurajimi i tyre për ruajtjen e cilësisë së ajrit gjatë aktiviteteve të tyre në planifikimin e proceseve për biznes.

Analiza e kostos

Miratimi i ndryshimeve dhe plotësimeve në Ligjin bazik për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja nuk ka një kosto shtesë dhe mund të konkludohet se nuk ka implikime financiare.

Tabela më poshtë përmban koston vjetore të shërbimeve, për zbatimin e ligjit

<i>Kategoritë shpenzimeve</i>	<i>e</i>	<i>Shpenzimet faktike në vitin paraprak</i>	<i>Buxheti këtë vit</i>	<i>KASH për vitin e ardhshëm</i>
-------------------------------	----------	---	-------------------------	----------------------------------

<i>Buxheti i Ministrisë:(shëno secilin lloj të shpenzimit) total buxheti i Ministrisë duke përfshi kapitale dhe mallra e shërbime paga mëditje dhe shpronësimet</i>	44,236,781.69	44,870,026	46,000,000.00
<i>Buxhetet tjera: (shëno secilin lloj të shpenzimit) Financimet nga huamarrjet, mallra dhe shërbime dhe kapitale</i>	1,250,687.87	2,915,000	
<i>Financimi nga donatorët, nga linja mallra shërbime dhe paga mëditje si dhe investime kapitale</i>	592,024.22	780,108.58	
<i>Shpenzimet e drejtpërdrejta nga Ministria e Financave</i>	0	0	

Tabela më poshtë përmban një analizë të kostos së të tri opsioneve

Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimit Financiar				
	(000 Euro)			
	Viti aktual	Viti 2	Viti 3	Viti 4
Opsioni 1				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0	0	0	0
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	0	0	0	0
Financimi i pritur nga donatoreve	0	0	0	0
Opsioni 2				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0	0	0	0

Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	0	0	0	0
Financimi i pritur nga donatorët	0	0	0	0
Opsioni 3				
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0	0	0	0
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	0	0	0	0
Financimi i pritur nga donatorët	0	0	0	0

Ndikimi

Ndikimi ekonomik dhe social- Në zhvillimin e Republikës së Kosovës, sukcesi afatgjatë në zhvillimin ekonomik dhe social do të varet nga qëndrueshmëria e politikave të caktuara, në fushën e industrisë, energjisë, minierave, transportit, bujqësisë etj; por secila nga këto politika, pa marrë parasysh nëse shikohen ndaras ose bashkërisht, me të tjerat, është e varur nga kapaciteti bartës i mjedisit.

Arritja e baraspeshës së dëshiruar mes aktivitetit njerëzor dhe mbrojtjes së mjedisit-cilësisë së ajrit, kërkon ndarje të përgjegjësive e cila është e drejtë dhe në mënyrë të qartë e definuar nga referenca konsumuese dhe sjellja ndaj mjedisit dhe resurseve natyrore.

KAPITULLI 7

Konsultimi

Procesi i konsultimeve është inicuar duke bërë prezantimin e draft dokumentit në ueb faqen e Ministrisë dhe shpërndarjen e tij nëpër institucione, përfaqësuesit e të cilëve janë pjesë e hartimit të dokumentit, duke përfshirë edhe organizimin e debatit publik. Dokumenti është kompletuar, pas shqyrtimit të komenteve të dhëna nga palët e interesuara.

Për ndryshimin dhe plotësimin e këtij Ligji janë konsultuar departamentet brenda Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe është arritur përfundimi se duhet të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja.

Po ashtu Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka marr mendime lidhur me këtë koncept dokument edhe nga Ministritë tjera: Ministria e Shëndetësisë, Ministria e

Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Financave, konsultimit me komuna dhe palët tjera dhe gjatë konsultimeve të legjislacionit relevant të BE-së.

Gjatë procesit të konsultimeve nuk ka mbërri në MMPH asnjë koment. Bazuar në këtë fakt është konsideruar se ka nevojë për ndryshimin e ligjit ekzistues, respektivisht hartimin e Ligjit të ri për këtë fushë që do të jetë në pajtim me përkushtimin e Qeverisë për vendosjen e ligjshmërisë dhe rregullave për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, nga ndotja e ajrit.

Mbrojtja e cilësisë së ajrit, shtresës së ozonit dhe ndryshimet klimatike janë pjesë e politikës së Komunitetit Evropian, për të arritur një nivel të lartë të shëndetit të njeriut dhe mbrojtjen e mjedisit.

KAPITULLI 8

Krahasimi i Opsioneve

Me analizën e bërë opsioni i tretë është opsion i rekomanduar- miratimi i Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja. Ky opsion siguron kornizën me të cilën do të arrihet mbrojtja dhe zvogëlimi i ndotjes së ajrit në Republikën e Kosovës në linjë me standardet e përcaktuara dhe parimet e praktikave më të mira, do të përmirëson gjendjen e cilësisë së ajrit veçanërisht në zonat urbane ku trafiku është më i dendur dhe industritë janë më të koncentruara, që do të ndikon në mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe mjedisit.

KAPITULLI 9

Rekomandimi

Ajri i pastër është esencial për cilësi të mirë të jetës.

Bazuar në analizën e bërë propozuesi ka shqyrtuar një sërë alternativash të mundshme. Opsioni i rekomanduar është hartimi i Ligjit të ri për mbrojtjen e ajrit nga ndotja që nënkupton opsionin e tretë, pasi që Ligji ekzistues ka nevojë për ndryshime dhe plotësime më shumë se 40%.

Masat dhe obligimet e përcaktuara në Ligjin e ri të Mbrojtjes së Ajrit nga Ndotja, paraqesin obligim për të gjithë sektorët e komuniteteve dhe janë përgjegjëse për të realizuar veprimet për arritjen e objektivave për cilësinë e ajrit.

Bazuar në këtë koncept dokument, pas miratimit, me vendim nga Qeveria, MMPH do të kryesoj grupin punues në të cilin do të marrin pjesë edhe përfaqësues nga Ministrinë tjera relevante, konform Rregullores së Punës së Qeverisë.

Planifikohet që drafti përfundimtar i ndryshimit dhe plotësimit të këtij Ligji të kryhet në kuartalin e katërt të vitit 2014.

Kostoja e përafërt për zbatimin e këtij Ligji është 44,870,026.

KAPITULLI 10

Komunikimi

Para se të dërgohet në Qeveri për miratim drafti i parë i projektligjit do të dërgohet në konsultime paraprake dhe do të publikohet në ueb-faqen e MMPH-së, për qëllime të konsultimit të akterëve të tjerë të interesuar.

Pas miratimit të Koncept dokumentit në fjalë, grupi punues do të filloi me hartimin e Ligjit për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja.